



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 18.09.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË, FAZA II”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 29.05.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, Faza II” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantoi projektligjin, Z. Arbian Mazniku, Zv. Kryetar i Bashkisë së Tiranës

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfË Frankfurt am Main (KfË), që propozohet për ratifikim me anë të këtij projektligji synon financimin me një fond grant prej 2 032 179.23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë njëzet e tre) euro të programit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje propozohet në vijim të marrëveshjes qeveritare të nënshkruar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit energjitike, faza II”, e cila është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.94/2017.

Me qëllim vënien në jetë të financimit të rënë dakord me anë të marrëveshjes qeveritare si dhe realizimin e programit përkatës, nevojitet lidhja e marrëveshjes financiare me KfË, si institucioni financiar i ngarkuar nga qeveria gjermane për akordimin dhe zbatimin e financimeve që sigurohen në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve.

Sigurimi i këtij financimi synon zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë në rehabilitimin e godinave të konvikteve të Universitetit të Tiranës, ku parashikohet rehabilitimi i pesë godinave.

5.0 Efektet financiare

Kostoja e projektit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë vlerësohet në shumën prej 7.8 milionë eurosh, e cila do të financohet nga:

a) KfË-ja me anë të granteve në shumën totale prej rreth 6.5 milionë eurosh (rreth 2 milionë euro nëpërmjet marrëveshjes aktuale të financimit dhe 4.5 milionë euro me anë të një marrëveshjeje tjetër financimi);

b) Buxheti i shtetit i cili do të mbulojë TVSH-në dhe kostot lokale të projektit, kosto këto të parashikuara në shumën totale prej 1.3 milionë eurosh.

6.0 Diskutimet në Komision :

Deputete në komision u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit bazuar në pyetjeve dhe përgjigjet e marra nga përfaqësuesit e ministrive, dhe pasi shqyrtuan projektligjin e votuan dhe miratuan atë në parim, nen për nen dhe në tërësi.

7.0 Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, Faza II” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2,të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

